



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:213083

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876223

KPPP.nr.1625/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbarimore të kreditorit Komuna e Prishtinës, me seli në rr. "UÇK", në Prishtinë, kundër debitorit "International Invest Group" SH.P.K., me NUI: 810005620, me seli në rr. "Abdyl Frashëri", p.nr., në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.78/23, të datës 23.02.2023 të Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 27.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit "International Invest Group" SH.P.K., ANULOHET Urdhri Përmbarimor P.nr.78/23 i datës 23.02.2023, i Përmbaruesit Privat Destan Bujupaj dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbarimi në këtë çështje përmbarimore.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Komuna e Prishtinës, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.78/23 të datës 23.02.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të Aktvendimit 05Nr. 351/02-0262620/18, të datës 01.08.2019 të Drejtorisë së Urbanizmit, Komuna e Prishtinës, t'ia paguajë kreditorit borxhin në shumën prej 63,682.27 €, si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, me bllokimin e të gjitha llogarive bankare të debitorit, si dhe me sekuestrimin, vlerësimin e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit dhe me shitjen e tyre të bëhet inkasimi i borxhit në llogari të kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, e ka kundërshtuar urdhrin përmbartimor duke theksuar ndër të tjerash se dokumenti në bazë të së cilit është lëshuar urdhri përmbartimor, nuk ka titull ekzekutiv dhe nuk ka tipare të përmbartueshmërisë dhe nuk bënë pjesë në dokumentet e besueshme sipas nenit 29 të LPP-së. Po ashtu, ka theksuar se kreditori ka humbur afatin kohor brenda të cilit mund të kërkohet përmbartimi dhe si rrjedhojë është arritur afati i parashkrimit. Gjykatës i ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, të hedhet poshtë si i pa bazuar dhe i pa lejuar urdhri përmbartimor.

Kreditori në përgjigjen në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim duke theksuar ndër të tjerash se dokumenti përmbartues i nxjerr në procedurë administrative/kundërvajtëse është bërë i përmbartueshëm sipas rregullave me të cilin rregullohet kjo procedurë përmbartimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit, të vërtetohet urdhri për përmbartim, si dhe të obligohet debitori që të përmbush obligimin sipas këtij urdhri së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore deri në përfundim të kësaj çështje.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit si dhe shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së dhe nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 Për Procedurën Përmbartimore, gjeti se prapësimi i debitorit është i bazuar dhe se urdhri përmbartimor duhet të anulohet dhe procedura përmbartimore të përfundohet në tërësi për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 21 të LPP-së, është përcaktuar se: “Organi përmbartues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbartimin vetëm në bazë të dokumentit përmbartues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër”. Ndërsa, sipas nenit 24.3 të LPP-së, “Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbartimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë”.

Me nenin 27.1 të LPP-së, janë përcaktuar në mënyrë taksative elementet të cilat duhet ti përmbaj dokumenti përmbartimor për të shërbyer si dokument i përshtatshëm për përmbartim, ku sipas kësaj dispozite përcaktohet se: “*Dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit*”.

Gjykata, duke ju referuar dispozitave të cituara si dhe bazuar në shkresa të lëndës, gjeti se Aktvendimi 05 Nr. 351/02-0262620/18, i datës 01.08.2019, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë, përkatësisht nuk i plotëson kushtet për përmbarim të përcaktuara me nenin 24, paragrafi 3 dhe nenin 36 të LPP-së, pasi që i njëjti nuk është përmbarues i klauzolës e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, me ç'rast edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Përveç të metave të lartcekura, gjykata gjen se aktvendimi në fjalë nuk i plotëson as kushtet e përcaktuara në nenin 27.1 të LPP-së, pasi që në aktvendim është caktuar lartësia e taksës për leje ndërtimore pronarëve – persona fizik me investitor International Invest Group SH.P.K., mirëpo nuk është përcaktuar se kush është i detyruar për pagesën e taksës dhe se nuk është treguar koha e përbushje së detyrimit. Ndërsa, bazuar në pikën V të dispozitivit të këtij aktvendimit, pasojë e mos përbushjes është përcaktuar refuzimi i lejes ndërtimore, dhe jo detyrimi për ekzekutim të dhunshëm të lartësisë së takës së caktuar për dhënien e lejes ndërtimore.

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti, mbi të cilin mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilit përmbaruesi privat ka lejuar përmbarimin, nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit duhet të anulohet.

Meqenëse gjykata gjeti se dokumenti mbi bazën e së cilit është lejuar urdhri nuk përmbar dokument përmbarimor ngase nuk ka tipare të përmbarueshmërisë dhe si i tillë nuk mund të shërbej si dokument për të iniciuar procedurën përmbarimore, gjykata nuk i trajtoi fare pretendimet e tjera të palëve ndërgjyqëse.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1625/23, datë 28.06.2024

Gjyqtari
Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.